



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 112/22-4856/22
Dt. 14.03.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja f dhe nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 57 dhe 62 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË BUJQËSISË, ZHVILLIM
RURAL DHE INSPEKCIONE

I

z.Erdjan Limançe, emërohet në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillim Rural dhe Inspekcione në Komunën e Dragashit.

II

Mandati i drejtorit do të fillon nga data 14.03.2022 dhe do të jetë i njëjtë me mandatin e kryetarit të Komunës. Emërimi i bërë me këtë vendim mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga ana e kryetarit të Komunës.

III

Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin nr.-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Dragashit dhe udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës si dhe në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

IV

I emëruari do të raportoj rregullisht kryetarit të Komunës për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që e udhëheqë.

V

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kabineti i Kryetarit, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.
Shtojcë: Leternjoftimi

Kryetari i Komunës

Bexhet Xheladini

- Vendimi i'u dërgohet:
- Të emëruarit,
- Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
- Sektorit të Personelit,
- Arkivës së Kryetarit.

